



Prishtinë, 10, dhjetor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1329_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Rregullën dhe Metodologjinë për Hartimin e Balanceve të Energjisë; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë sh.a. të datës 3 dhjetor 2020, për miratimin e dokumentit: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2021-2030.

Pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 10 dhjetor 2020, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET BILANCI AFATGJATË I ENERGISË TERMIKE për periudhën 2021-2030 i NP Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë sh.a.**

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar draftin final të dokumentit: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike për periudhën 2021-2030 nga NP Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë sh.a. si bartës i Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.
 2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2021-2030" të dorëzuar nga NP Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë sh.a. dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi menjëherë të publikojë dokumentin "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2021-2030" në faqen elektronike zyrtare të tij.**
- III. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të monitoroj implementimin e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.**



IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.

VI. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Arsim Janova, UD Kryesues

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Izet Ruzhiti, Anëtar

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike – 2021-2030, NP Ngrrohtorja e Qytetit Gjakovë sh.a.

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së